



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SIGURISË

Nr. Prot. 294 Date 03.06.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

Nr. Prot. 8715 Date 3.6.2021

### MARREVESHJE

#### “PER FORMIMIN DHE KUALIFIKIMIN E PUNONJESVE TE POLICISE BASHKIAKE SHKODËR ”

Sot ne Tirane, me date 03.06 2021, ndermjet paleve:

**Akademia e Sigurise** me adrese: Sauk Tirane, perfaqesuar nga Drejtori/Rektori, Drejtues i Larte Bilbil MEMAJ ne vijim referuar si “Akademia”

**Bashkia Shkoder**, me adrese: Rruga 13 Dhjetori Nr. 1 Shkoder, perfaqesuar nga Kryetari Zj. Voltana ADEMI ne vijim referuar si “Bashkia”

#### Me synimin:

Rritje e kapaciteteve profesionale ne funksion te realizimit te misionit dhe detyrave ligjore, nga ana e Policise Bashkiake Shkodër, formimi baze, nepermjet trajnimit ne Akademin e Sigurise, për cdo punojës të Policisë Bashkiake.

#### Biem dakort si me poshte:

##### Neni 1

##### Objekti

Objekti i kesaj marreveshje, eshte trajnimi i punonjesve te Policise Bashkiake Shkodër, ne Akademin e Sigurise, sipas nje program te miratuar per kete qellim.

##### Neni 2

##### Qellimi

Qellimi i kesaj marreveshje eshte, rritja e kapaciteteve te strukturave te punonjesve te Policise Bashkiake Shkodër, nepermjet trajnimeve profesionale ne funksion te rritjes se efektivitetit te punes se tyre, ne sherbim te qytetareve.

##### Neni 3



## Baza ligjore

- Ligji 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore” i ndryshuar
- Ligji nr. 8224, date 15.05.1997 “Per organizimin e funksionimin e Policise se Bashkise dhe Komunes” i ndryshuar
- VKM nr. 881, date 28.10.2020 “Per dhenien e statusit te vecante Akademise se Sigurise, si institucion i vetem publik i arsimit te larte ne fushen e rendit e te sigurise publike, si dhe organizimin e funksionimin e saj”

## Neni 4

### Te drejtat e detyrimet e paleve

#### I. Te drejtat e detyrimet e Bashkise:

1. Mbeshtetur ne nevojat e saj, i dergon Akademise se Sigurise, kerkesen per trajnim te punonjesve te Policise Bashkiake, te ndare sipas niveleve si dhe listat e pjesemarrsesve.
2. Siguron pjesmarjen e punonjesve te Policise Bashkiake, ne trajnimin ne daten e percaktuar nga te dy palet.
3. Perfaqesues te autorizuar te Bashkise kontaktojne me Drejtorine e Planifikimit dhe Kontrollit, per mbarevajtjen e trajnimit ne Akademi e Sigurise.
4. Ne perfundim te kursit, Akademia e Sigurise informon me shkrim rreth ecurise se programit dhe nivelit te pervetsimit te tij nga kursantet. Informon edhe mbi problematikat e shfaqura gjate zhvillimit te procesit.

#### II. Te drejtat dhe detyrimet e Akademise se Sigurise:

1. Akademia e Sigurise eshte pergjegjese, sipas kesaj marrveshje, per organizimin e mbarevajtjen e trajnimit te punonjesve te Policise Bashkiake Shkodër.
2. Merr masa per zhvillimin e trajnimit te punonjesve te Policise Bashkiake Shkodër sipas programit te pergatitur e dakortuesar paraprakishte.
3. Siguron zhvillimin e trajnimit ne baze te standarteve shteterore te mesimdhenies, duke hartuar dokumentacionin e nevojshem per kete qellim, si dhe duke ushtruar kontroll te vazhdueshem lidhur me respektimin e frekuentimit dhe metodologjise se mesimdhenies.
4. Ne perfundim te trajnimit duke u mbeshtetur edhe ne rezultatet perfundimtare te te gjithë personat e vlersuar pozitivisht pajisen me çertifikate.
5. Ne perfundim te cdo trajnimit kryhet vleresimi, me qellim analizimin e arritjes se qellimit dhe objektivave te tij.
6. Informon me shkrim Bashkine ne perfundim te trajnimit lidhur me ecurine e tij, si per mundesine e permiresimit te programit mesimore.

#### III. Te drejtat e detyrimet e perbashketa:

1. Palet bashkepunojne per hartimit e programit mesimore per trajnimin e punonjesve te Policise Bashkiake, i cili miratohet nga Drejtori/rektori i Akademise se Sigurise.
2. Gjate zhvillimit te trajnimit punonjesit e Policise Bashkiake Shkodër ne ambientet e auditoret e Akademise se Sigurise, detyrohet te zbatojne Rregulloren e Akademise se Sigurise.

## Neni 5

### Pikat e kontaktit dhe komunikimit:

Me qellim lehtësimin e zbatimit e kesaj marrveshje, palet caktojne pika e kontaktit si me poshte:  
Per Akademi e Sigurise: Drejtori i Planifikimit dhe Kontrollit.





Per Bashkine Shkoder: Kryeinspektori i Policise Bashkiake.

Palet bashkepunojne dhe zgjidhin problemet qe lindin ne interest e qellimit te kesaj marreveshje.

## Neni 6

### Kohezgjatja e marreveshjes:

1. Marreveshja lidhet per nje afat dy-vjecar me te drejte rinovimi.
2. Secila nga palet mund te terhiqet dhe te nderprese ne menyre te njeanshme marreveshjen, duke njoftuar me shkrim palen tjetër, 2 muaj perpara nderprerjes.
3. Nese nje nga palet terhiqet dhe kerkon nderprerjen ne menyre te njeanshme te marreveshjes, punonjesit e Policise Bashkiake Shkodër qe kane filluar procesin e trajnimit apo jane ne trajnim duhet te vijojne trajnimin deri ne perfundim te tij.

## Neni 7

### Shtesa, ndryshime, zgjidhja e mosmarreveshjeve:

1. Palet angazhohen per permbushjen e detyrimeve dhe kushtetve te parashikuara ne kete marreveshje.
2. Palet mund te bejne shtesat e ndryshimet e nevojshme te kesaj marreveshje ne cdo kohe, me pelqimin e ndersjellte, te paraqitur me shkrim.
3. Palet zgjidhin me mirekuptim cdo mosmarreveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj marreveshje.
4. Ne rast se palet nuk arrijne mirekuptim lidhur me mosmarreveshjet te mundshme, per zgjidhjen e tyre i drejtohen gjykates kompetente.

## Neni 8

### Dispozitat e fundit:

Kjo marreveshje hartohet ne kater kopje te barazvlefshme ne gjuhen shqipe, nga dy kopje per secilen pale, te nenshkruara nga palet dhe te vulosura me vulat zyrtare te institucioneve perkatese.

## Neni 9

### Hyrja ne fuqi:

Kjo marreveshje hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit te saj nga palet.

**AKADEMIA E SIGURISE**

**DREJTORI/REKTORI**

**DREJTUES I LARTE**

Z. Bilbil MEMAJ



**BASHKIA SHKODER**

**KRYETARI**

Zj. Voltana ADEMI

